

Tiranë, më 19.1.2024

Njoftim për shtyp

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Pas verifikimit të prezencës së palëve, Komisioneri Publik parashtroi qëndrimin mbi *Gjetjen dhe Opinionin* e vëzhguesve ndërkombëtarë, të depozituar rishtazi në Kolegj.

Komisioneri Publik, lidhur me përmbajtjen e *Gjetjes* mbi parimin e proporcionalitetit dhe lidhjen e tij me Analizën financiare, vlerësoi se vëzhguesi ndërkombëtar ka dëshiruar të tërheqë vëmendjen e Kolegjit dhe të nënvizojë praktikatat e ndryshme që tregojnë diferenca negative minimale, të cilat kanë çuar në shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në zbatimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 (në vendimet e formës së prerë).

Lidhur me përmbajtjen e *Mendimit* për vlerësimin e pasurisë, Komisioneri Publik, në drejtim dhe të detyrave të lëna nga Kolegji, vlerëson se vëzhguesi ndërkombëtar, në këtë pikë të *Mendimit*, ka saktësuar qartë situatën faktike konkrete, duke mbështetur përfundimin e çmimit të blerjes së apartamentit në shumën prej 36.000 dollarë, si dhe ka vlerësuar se kjo situatë është parashtruar saktë në ankimin e Komisionerit Publik.

Në vijim, pasi palët nuk referuan kërkesa të tjera procedurale, trupi gjykues, i konsultuar në vend, vendosi të mbyllë shqyrtimin gjyqësor të çështjes dhe të shtyjë seancën më datë 26.1.2024, ora 12:00, për paraqitjen e bisedimeve përfundimtare.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.